

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**FEDERATA SHQIPTARE E SPORTIT UNIVERSITAR**



**RREGULLORJA E BRENDSHME**

**FSHSU**

**TIRANË**

Federata Shqiptare e Sportit Universitar

Themeluar: 21.12.2017

**PRESIDENTI**

Besnik VELIU



**SEKRETAR I PËGJITHSHËM**

Ervin PEPI



**Hartuar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Federatës Shqiptare të Sportit Universitar**

*Nuk lejohet ribotimi i këtyre rregullave në asnjë mënyrë dhe formë, me Vendim të Komitetit Drejtues të Federatës Shqiptare të Sportit Universitar.*

Mars 2018

## Tabela e Përmbajtjes

Qëllimi	4
Krijimi	4
Parimet	4
Objektivat	5
Anëtarët	6
Sportisti Universitar	8
Asambleja e Përgjithshme e Zakonshme/Jashtëzakonshme	8
Mbledhjet	11
Presidenti	12
Komiteti Drejtues	12
Gjyqatrët	13
Gjyqtari Ndihmës	13
Kampionatet	14
Burimet Financiare dhe Baza Materiale	15
Trajtimi financiar i punonjësve që dërgohen me shërbim brenda/jashtë vendit	17
Komisioni Teknik	18
Komisioni i Gjyqtarëve	20
Komisioni Disiplinës	21
Komisioni Financës	23
Komisioni i Apelit	23
Ekipet përfaqësuese	24
Dispozita Të Fundit	26



## NENI 1

### *Qëllimi*

Qëllimi i kësaj rregullore është:

- a) përcaktimi i rregullave dhe i detyrave të hollësishme të organizimit, funksionimit të brendshëm dhe marrëdhëniet ndërmjet niveleve të ndryshme në FSHSU-së
- b) përcakton rregulla mbi koordinimin e funksioneve, administrimin e dokumentacionit, pajisjeve, rregullat e etikës dhe procedura të tjera të menaxhimit;
- c) të shërbejë si mbështetje ligjore për zgjidhjen e të gjitha mosmarrëveshjeve midis forumeve drejtuese, shoqatave, klubeve dhe anëtarëve të tjerë të FSHSU-së.

## NENI 2

### *Krijimi*

1. Federata Shqiptare e Sportit Universitar është krijuar më 21.12.2017 dhe vepron në përputhje me dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Ligji Nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat jofitimprurëse", i ndryshuar, Ligjit Nr. 8789, datë 07.05.2001 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse", Ligjit Nr. 79/2017 "Për Sportin", si dhe në përputhje me akte të tjera ligjore dhe nënligjore që rregullojnë këtë aktivitet.
2. Federata Shqiptare e Sportit Universitar është anëtare e Federatës Botërore të Sportit Universitar dhe Federatës Europiane të Sportit Universitar që nga viti 2017 dhe si e tillë ajo zbaton të gjitha rregullat, vendimet e tyre dhe kërkon respektimin dhe batimin e tyre nga të gjithë anëtarët e saj.

## NENI 3

### *Parimet*

1. Federata Shqiptare e Sportit Universitar do të respektojë parimet e përgjithshme dhe themelore të: Federatës Botërore të Sportit Universitar (FISU), Komitetit Olimpik Botëror (IOC), Federatës Europiane të Sportit Universitar (EUSA), Kartës Ndërkombëtare të Edukimit Fizik dhe Sporteve të UNESCO-s, Kartës Evropiane të Sporteve të Këshillit të Evropës, Kartës Evropiane të Sportit për të Gjithë të Këshillit të Evropës.
2. Parimet që drejtojnë misionin e Federatës Shqiptare të Sportit Universitar janë:
  - a) Sporti etik dhe amator – një alternativë tjetër e sportit;

- b) Loja në sport – Përfshirja/integrimi social dhe universitar;
- c) Shëndeti në sport – Ekuilibri i studentit;
- d) Sporti edukativ – Ekselenca akademike dhe sportive;
- e) Qytetaria në sport – Formimi i drejtuesve të ardhshëm;
- f) Ndërveprimi në sport – Shërbime kulturore.

## NENI 4

### *Objektivat*

1. T'i ofrojë dhe sigurojë institucioneve të arsimit të lartë, mundësinë për të forcuar rolin e sportit në universitete në shërbim të studentëve dhe të komuniteteve.
2. Të zhvillojë aktivitete dhe programe sportive në/ nëpërmjet shoqatave sportive studentore të IAL-ve;
3. Të promovojë vlerat sportive dhe inkurajojë praktikën sportive brenda IAL-ve në harmoni me frymën universitare;
4. Të ofrojë dhe garantojë mundësi të barabarta për çdo student të Republikës së Shqipërisë për të praktikuar sportin gjatë dhe pas studimeve;
5. Të zhvillojë potencialin sportiv studentor në drejtim të progresit dhe pasurimit të aftësive të cilat formojnë qytetarë të përgjegjshëm;
6. Të organizojë, të drejtojë, të kontrollojë dhe të vëzhgojë veprimtaritë sportive me studentët e arsimit të lartë, në nivel rajonal e kombëtar, në të gjitha disiplinat sportive;
7. Të organizojë kampionatet universitare në të gjitha disiplinat sportive dhe të shpallë kampionin kombëtar të universiteteve;
8. Të organizojë ekipet përfaqësuese në aktivitetet ndërkombëtare të sportit universitar.
9. Të kontribujë në përmirësimin e infrastrukturës sportive në institucionet e arsimit të lartë, për zhvillimin e aktivitetit sportiv, në përputhje me standardet bashkëkohore.

## NENI 5

### *Anëtarët dhe anëtarët provizorë*

1. Anëtarët e Federatës Shqiptare të Sportit Universitar janë persona juridikë, shoqata sportive, të cilat pranojnë aderimin pranë saj, duke respektuar të gjitha detyrimet statutore dhe rregullatore të funksionimit të FSHSU.



2. Pas regjistrimit në gjykatë si person juridik, shoqata kërkon të drejtën e anëtarësimit në FSHSU.
3. Komiteti Drejtues i jep shoqatës të drejtën e të qenit anëtar provizor i FSHSU, deri në Asambleenë e Përgjithshme të rradhës. Anëtarë provizorë janë gjithashtu të gjithë subjektet e përcaktuar në pikën 9 të këtij neni.
4. E drejta e anëtarësisë fitohet pas vendimit në favor nga Asambleja e Përgjithshme. Asambleja e Përgjithshme vendos mbi anëtarësinë e një anëtari, por ajo nuk mund ta refuzojë atë për sa kohë organizimi i kërkuarit nuk është në kundërshtim me statutin e FSHSU.
5. Shoqatat sportive studentore të institucioneve të arsimit të lartë që kërkojnë të jenë anëtarë të FSHSU, duhet të jenë të regjistruara sipas dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Ligji Nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat jofitimprurëse", i ndryshuar, Ligji Nr. 8789, datë 07.05.2001 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse", Ligji Nr. 79/2017 "Për Sportin", si dhe në përputhje me akte të tjera ligjore dhe nënligjore që rregullojnë këtë aktivitet.
6. Statutet e shoqatave sportive studentore duhet të jenë në përputhje me statutin dhe rregulloren e Federatës Shqiptare të Sportit Universitar. Një kopje e statutit dhe vendimit të gjykatës do të dorëzohet sëbashku me kërkesën e parë për anëtarësim. Në çdo rast ndryshimi të përmbajtjes së statutit, një kopje e tij dorëzohet në zyrën e FSHSU-së.
7. Shoqatat sportive studentore duhet të përfaqësojnë jo më shumë se një institucion të arsimit të lartë. Statutet e tyre nuk duhet të përmbajnë dispozita në kundërshtim me objektin apo frymën e statutit të FSHSU-së.
8. Çdo institucion i arsimit të lartë themelon, sipas organizimit të tij, shoqatën sportive studentore. Institucionet e arsimit të lartë të cilat kanë filiale brenda qarkut mund të krijojnë një shoqatë sportive të përbashkët, pas:
  - a) Marrëveshjes me drejtuesit e institucioneve të përfshira;
  - b) Opinionit në favor nga Komiteti Drejtues i FSHSU-së.
9. Anëtarët provizorë të Federatës Shqiptare të Sportit Universitarë janë:
  - a) Shoqatat sportive studentore të cilat kanë dorëzuar kërkesën e anëtarësimit pranë FSHSU-së , kanë paguar kuotën e anëtarësimit dhe janë në pritje të vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të FSHSU mbi fitimin e anëtarësisë;

- b) Institucionet e arsimit të lartë, që nuk kanë themeluar shoqatën sportive studentore, por që pas pranimit të kërkesës për anëtarësi pranë FSHSU, kanë përmbushur detyrimin e kontributit për FSHSU nëpërmjet pagesës së kuotës së përcaktuar nga Asambleja e Përgjithshme e FSHSU;
    - i. Anëtarësia provizore përfundon me përfundimin e kohëzgjatjes së saj.
    - ii. Në rastin kur IAL themelon shoqatën sportive studentore dhe përmbush të gjithë detyrimet e tjera statutores, kohëzgjatja e anëtarësisë provizore bëhet e vlefshme deri në Asambleenë e Përgjithshme të rradhës.
  - c) Anëtarësia provizore është e vlefshme vetëm për një vit kalendarik nga data e pranimit të kërkesës dhe lejon informimin dhe pjesëmarrjen në aktivitetet dhe kampionatet kombëtare dhe ndërkombëtare, të organizuara apo strukturuara nga FSHSU.
10. Anëtarët e regjistruar në FSHSU janë të detyruar të kontribuojnë për FSHSU nëpërmjet pagimit të kutoave të përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme.
11. Shoqatat Sportive Universitare, në alikimin e parë për anëtarësim duhet të plotësojnë një kërkesë anëtarësimi dhe ta dorëzojnë pranë FSHSU-së si dhe të paguajnë kuotën e anëtarësimit që vendoset nga Asambleja e Përgjithshme e FSHSU-së. Procedura e anëtarësimit duhet të dorëzohet në fillim të vitit akademik dhe përpara çdo angazhimi të shoqatës në sezonin sportiv.
12. Shoqatat sportive studentore duhet të përmbushin detyrimin e anëtarit aktiv sipas kriterëve:
- a) Institucionet e Arsimit të Lartë që kanë të regjistruar brenda vitit akademik deri në 1.000 (një mijë) studentë do të paguajnë taksën në shumën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë.
  - b) Institucionet e Arsimit të Lartë që kanë të regjistruar brenda vitit akademik nga 1001 (një mijë e një) deri në 9.000 (nëntë mijë) studentë do të paguajnë taksën në shumën 100.000 (njëqind mijë) lekë.
  - c) Institucionet e Arsimit të Lartë që kanë të regjistruar brenda vitit akademik mbi 9.000 (nëntë mijë) studentë do të paguajnë taksën në shumën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë për fakultet
13. Pranimi i antarëve të rinj në FSHSU-së bëhet me shumicë të thjeshtë 50% + 1 të të gjithë anëtarëve.
14. Anëtarët e FSHSU-së duhet të kenë selinë ose vendbanimin në territorin e Republikës së Shqipërisë.



### *Sportisti universitar*

1. Sportistët universitarë janë të gjithë lojtarët e ekipeve të shoqatave sportive studentore dhe/ose institucioneve të arsimit të lartë që garojnë në aktivitetet dhe/ose kampionatet kombëtare dhe ndërkombëtare të organizuara apo strukturuara nga FSHSU.
2. Sportistët universitarë duhet të jenë detyrimisht studentë që regjistrohen rregullisht, apo kanë qenë si të tillë, në një institucion të arsimit të lartë ose në një institucion të ngjashëm, statusi akademik i të cilit është i njohur nga Ministria Përgjegjëse për Arsimin.
3. Sportistët universitarë që kanë përfunduar studimet e tyre dhe nuk janë më të regjistruar në një institucion të arsimit të lartë, duhet të kenë diplomë bachelor ose ekuivalente.
4. Shoqata sportive studentore është përgjegjëse për verifikimin dhe vërtetimin e kualifikimit të sportistit universitar;
  - a) Të kenë nënshtetësinë shqiptare;
  - b) Të jenë mbi 17 vjeç dhe nën 28 vjeç në fillim të janarit të vitit të ngjarjes;
  - c) Të kenë numër matrikullimi.
5. Për garat ndërkombëtare, FSHSU pranon ish-studentë ose studentë nga institucionet e përmendura, të cilët kanë marrë diplomën për kryerjen e arsimit të lartë në vitin që i paraprin ngjarjes.

## **NENI 7**

### *Asamblea e Përgjithshme e Zakonshme /Jashtëzakonshme*

1. Asambleja është organi vendimmarrës i FSHSU-së
2. Asambleja zgjedh Presidentin, me mandat 5 (pesë) vjeçar, me të drejtë rikandidimi.
3. Asambleja zgjedh Komitetin Drejtues prej 7 (shtatë) anëtarësh, me mandat 5 (pesë) vjeçar, me të drejtë rikandidimi.
4. Asamblea e Përgjithshme mbledhet jo më pak se 1 (një) herë në vit.
5. Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme të Zakonshme dhe Jashtëzakonshme drejtohen nga Presidenti. Në mungesë të tij nga zëvendëspresidenti. Kur edhe ai mungon, mbledhja drejtohet nga anëtari më i vjetër i Komitetit Drejtues duke u emëruar Kryetar i Ditës.
6. Presidenti i FSHSU-së vendos kur mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Zakonshme apo Jashtëzakonshme nga një mbledhje e hapur, për të gjithë, të kalojë në një mbledhje me dyer të mbyllura ku të pranishëm janë vetëm personat që kanë të drejtë vote.



7. Asamblea e Përgjithshme mbledhet në fillim të vitit, ku vendos mbi objektivat për të realizuar.
8. Asamblea e Përgjithshme dhe Asamblea e Jashtëzakonshme thërret nga Komiteti Dretues, 30 (ditë) ditë përpara ditës së zhvillimit të saj.
9. Sekretari i Përgjithshëm bën njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Zakonshme dhe Jashtëzakonshme me njoftim elektronik ose postë ose shërbim rekomande.
10. Sekretari i Përgjithshëm thërret Asamblenë e Jashtëzakonshme kur të paktën 1/3 e anëtarëve të FSHSU-së bëjnë kërkesë me shkrim.
11. Sekretari i Përgjithshëm thërret Asamblenë e Jashtëzakonshme jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë pas marrjes së kërkesës me shkrim,.
12. Komiteti Drejtues vendos për rendin e ditës për Asamblenë e Përgjithshme.
13. Komiteti Drejtues vendos për rendin e ditës për Asamblenë e Jashtëzakonshme, kur ajo mbahet me kërkesën e 1/3 anëtarëve, rendi i ditës përmban pikat e ngritura nga këto anëtarë.
14. Rendi i ditës për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Zakonshme dhe Jashtëzakonshme, nuk mund të ndryshohet në çfarëdo kushtesh.
15. Rendi i ditës, raportet e aktiviteteve, buxheti, llogaritë dhe çdo dokument tjetër ju dërgohet anëtarëve 10 (dhjetë) ditë përpara mbledhjes së Asamblesë.
16. Çdo anëtarë ka të drejtën të propozojë përfshirjen e një çështje në rendin e ditës.
17. Kjo kërkesë duhet të paraqitet në zyrën e FSHSU-së jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë përpara mbledhjes.
18. Asamblea e Përgjithshme, përbëhet nga të gjithë përfaqësuesit e anëtarëve të saj të cilët kanë të drejtën e 1 (një) vote.
19. Çdo anëtar ka të drejtën të përfaqësohet deri me 3 (tre) anëtarë në Asamble.
20. Çdo anëtar ushtron të drejtën e votimit përmes delegatëve të tyre zyrtarë;
  - a) Çdo delegat ka të drejtën e 1 (një) vote;

- b) Çdo shoqatë ka 1 (një) delegat;
  - c) Shoqata me përfaqësimin e 1000 deri 5000 studentëve ka të drejtën e 1 (një) delegati shtesë;
  - d) Shoqata me përfaqësimin e 5001 deri 7000 studentëve ka të drejtën e 2 (dy) delegatëve shtesë;
  - e) Shoqata me përfaqësimin e 7001 deri 9000 studentëve ka të drejtën e 3 (tre) delegatëve shtesë;
  - f) Shoqata me përfaqësimin mbi 9000 studentëve ka të drejtën e 4 (katër) delegatëve shtesë.
21. Kolegjiumi i gjyqëtarëve ka të drejtën e 1 (një) vote.
22. Kolegjiumi i gjyqëtarëve ka të drejtën të përfaqësohet me 3 gjyqëtarë në Asamble.
23. Vota nuk mund të delegohet nga një anëtar në tjetrin.
24. Mund të marrin pjesë në Asamblenë e Përgjithshme pa të drejtë vote:
- a) Anëtarët e nderit të miratuar nga Asambleja;
  - b) Anëtarët e Komitetit Drejtues;
  - c) Sekretari i Përgjithshëm;
  - d) Përgjegjësi i Kampionateve.
25. Nuk mund të përfaqësohen me të drejtë vote në Asamblenë e Përgjithshme të FSHSU personat që kanë patur të drejtë vote në një federatë tjetër.
26. Sekretari i Përgjithshëm iu dërgon të gjithë anëtarëve procesverbalin e Asamblesë së Përgjithshme dhe Jashtëzakonshme jo më vonë se 20 (njëzet) ditëve nga mbledhja e saj.
27. Procesverbali nënshkruhet nga Presidenti, Sekretari i Përgjithshëm, cdo anëtar i Komitetit Drejtues, dhe cdo person që ka patur të drejtë vote,
28. Asambleja e Përgjithshme apo e Jashtëzakonshme është në kuorum nëse në mbledhjen e saj janë 50% + 1 e të gjithë anëtarëve.
29. Procesverbali i mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme apo Jashtëzakonshme ruhet në arkivë në dy kopje.

## NENI 8

### *Mbledhjet*



1. Komiteti Drejtues mbledhet jo më pak se 3 (tre) herë në vit.
2. Mbledhja e Komitetit Drejtues drejtohet nga Presidenti.
3. Presidenti bën njoftimin për Mbledhje të Zakonshme 7 (shtatë) ditë përpara.
4. Presidenti bën njoftimin për Mbledhje të Jashtëzakonshme 3 (tre) javë përpara zhvillimit të mbledhjes, kur të paktën 1/3 e anëtarëve të Asamblesë së FSHSU bëjnë kërkesë me shkrim.
5. Sekretari i Përgjithshëm merr pjesë në çdo takim të Komitetit Drejtues, pa të drejtë vote.
6. Mbledhjet e Komitetit Drejtues nuk mbahen në publik. Komitetit Drejtues mund të ftojë palë të treta të marrin pjesë. Këto palë të treta nuk kanë të drejtë votimi dhe mund të shprehin opinionin e tyre vetëm me miratim të Presidentit.
7. Për mbledhjet e Komiteti Drejtues mbahet procesverbal, i cili firmoset nga Presidenti, Sekretari i Përgjithshëm dhe nga çdo anëtar kryesisë pjesëmarrës në mbledhje.
8. Vendimet e Komitetit Drejtues duhet të zbardhen brenda 5 (pesë) ditëve, Sekretari i Përgjithshëm ia u dërgon të gjithë anëtarëve jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga mbajtja e mbledhjes.
9. Mbledhja e Komitetit Drejtues është në kuorum nëse në mbledhjen e saj janë 50% +1 e të gjithë anëtarëve.
10. Procesverbali i mbledhjes ruhet në arkivë në dy kopje.

## NENI 9

### *Presidenti*

1. Presidenti zgjidhet nga Asambleja me mandat 5 vjeçar me shumicë të cilësuar.
2. Presidenti përfaqëson FSHSU si i vetmi përfaqësues i saj
3. Presidenti kërkon thirrjen e asambles së zakonshme, të jashtëzakonshme dhe të Komitetit Drejtues.

4. Presidenti drejton Asamblenë e Zakonshme, të Jashtëzakonshme dhe të Komitetit Drejtues.
5. Presidenti siguron zbatimin e vendimeve të Asamblesë dhe të Komitetit Drejtues.

## NENI 10

### *Komiteti Drejtues*

1. Komiteti Drejtues menaxhon dhe drejton punët e FSHSU.
2. Komiteti Drejtues planifikon aktivitetet dhe kalendarin e veprimtarisë kombëtare dhe ndërkombëtare.
3. Komiteti Drejtues monitoron administrimin e FSHSU.
4. Komiteti Drejtues zgjedh zëvendëspresidentin.
5. Komiteti Drejtues përgatit mbajtjen e Asamblesë së Përgjithshme të Zakonshme dhe Jashtëzakonshme.
6. Komiteti Drejtues harton dhe miraton projekt-buxhetin dhe ja paraqet Asamblesë së Përgjithshme.

## NENI 11

### *Gjyqtari*

1. Gjyqtari drejton lojën në pajtim me rregullat e FISU dhe zbaton dispozitat e kësaj rregulloreje.
2. Gjyqtari është përgjegjës për atë çka ndodh brenda hapësirës së lojës.
3. Gjyqtari kujdeset që të ketë në hapësirën e lojës mjetet e nevojshme.
4. Gjyqtari informon Delegatin Teknik të FSHSU për çdo parregullsi eventuale.
5. Gjyqtari hedh shortin.



6. Gjyqtari ndëshkon lojtarët dhe trajnerët me karton.
7. Gjyqtari është përgjegjës për komandat gjatë lojës.
8. Gjyqtari kontrollon rradhën e shërbimeve, ndërrimin e anëve dhe përmirëson gabime eventuale, sapo i ka kuptuar.
9. Gjyqtari vendos për çdo pikë, përveç kur gjyqtari ndihmës e ka të drejtën e vendosjes.
10. Gjyqtari dërgon tek Delegati Teknik procesverbalin e ndeshjes/takimit.

## NENI 12

### *Gjyqtari ndihmës*

1. Gjyqtari Ndhmës kontrollon kohën e nxemjes, kohëzgjatjen e pushimit e kohëzgjatjen e lojës në ato sporte ku kjo dispozitë aplikohet.
2. Gjyqtari Ndhmës vendos nëse shërbimet anësore/këndit janë të rregullta në ato sporte ku kjo dispozitë aplikohet.
3. Gjyqtari dihmës asiston/ndihmon Gjyqtarin në konfirmimin e shënimit të pikëve.
4. Gjyqtari Ndhmës mund të ndërpresë lojën nëse janë shkelur kushtet e lojës në atë mënyrë që mund të ndikonin në rezultatin e lojës.
5. Vendimet e Gjyqtarit Ndhmës janë të plotëfuqishme kur kanë të bëjnë me fakte për të cilat i janë caktuar, në ato sporte ku kjo dispozitë aplikohet.

## NENI 13

### *Kampionatet*

1. Me këtë rregullore caktohet sistemi i garave ekipore dhe individuale të FSHSU për të gjitha sportet në të gjitha kategoritë.
2. Vendi, data, ora dhe mënyra e zhvillimit të çdo veprimtarie përcaktohet në kalendarin sportiv kombëtar, në përputhje me strukturën organizative miratuar nga Komiteti Drejtues i FSHSU.

3. Në të gjithë Kampionatet e organizuara nga FSHSU zbatohen rregullat e Federatës Kombëtare Sportive për atë disiplinë dhe kategori sportive.
4. Kampionatet e FSHSU-së janë gara shumë-sportëshe të shoqatave studentore sportive, të mbajtura çdo vit për ekipet e IAL-ve dhe studentët individualë të emëruar nga shoqatat e tyre studentore sportive të IAL-ve.
5. Fituesit e garave fitojnë titullin "Kampioni i Universiteteve Shqiptare" dhe fitojnë të drejtën të përfaqësojnë vendin në Garat Ndërkombëtare.
6. Pjesëmarrësit e Kampionateve janë shoqata sportive studentore përfaqësuese të IAL-ve dhe institucione të ngjashme me statusin e një institucioni të arsimit të lartë të njohur nga Ministria Përgjegjëse për Arsimin.
7. Anëtarët (garuesit dhe zyrtarët) e çdo IAL formojnë një delegacion, dhe një ekip i tillë zyrtarisht përfaqëson vetëm një universitet.
8. IAL pjesëmarrëse do të përdorin emrin e tyre. Emri i rajonit mund të shtohet gjithashtu, dhe duhet të përdoret në përputhje me emrin dhe shkurtimin, siç njihet nga FSHSU. Nëse përdorimi i emrit të një IAL nuk është i mundur për arsye teknike, atëherë shkurtimi do të përdoret në çdo dokument.
9. Përbërja e një delegacioni përcaktohet në rregulloren teknike të sportit përkatës. Delegacioni nuk mund të përfshijë më shumë garues sesa përcaktohet në rregulloren teknike të sportit përkatës.
10. Secili delegacion do të caktojë një Kryetar Delegacioni, i cili vetëm do të ketë të drejtë të përfaqësojë delegacionin e tij. Kryetari i Delegacionit nuk mund të jetë njëkohësisht i regjistruar si garues.
11. Delegacionet do të jenë përgjegjës për koston e tyre të udhëtimit në pikat e caktuara të mbërritjes / nisjes.
12. Delegacionet duhet të kenë sigurimin e duhur për të mbuluar udhëtimin dhe pjesëmarrjen e tyre në Kampionat.
13. Delegacionet do të sjellin 1 (një) flamur (me dimensione 1x2 metra) të IAL-së dhe 1 (një) flamur (me dimensione 1x2 metra) të shoqatës sportive studentore të tyre.
14. Kryetari i delegacionit ose përfaqësuesi i ekipit i autorizuar prej tij mund të ankimojë në emër të garuesve ose ekipit. Ankesat duhet të dorëzohen:
  - a) brenda 20 (njëzet) minutash pas përfundimit të ndeshjes tek Gjyqtari i ndeshjes për çështjet e ndeshjes;
  - b) gjatë garës tek Gjyqtari ndihmës për çështje teknike;
  - c) gjatë grës tek Gjyqtari ndihmës për çështjet jo-teknike;
  - d) brenda shtatë (7) ditëve pas Kampionatit për Komitetin Drejtues të FSHSU për çështjet e Kampionatit.



15. FSHSU mbledh të dhënat e pjesëmarrësve: emrin, adresën, vendbanimin, vendndodhjen, datën dhe vendin e lindjes, kombësinë, numrin e pasaportës, numrin e matrikullimit, gjininë, universitetin, fakultetin dhe vitin e studimit, numrin e telefonit dhe adresën e emailit. Këto të dhëna trajtohen në përputhje me Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr.48/2012 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

#### NENI 14

#### *Burimet financiare dhe baza materiale*

1. Burimet financiare dhe mënyra e përdorimit:
  - a) Burimet financiare përcaktohen në Statutin e FSHSU-së;
  - b) Grandi i miratuar nga MASR.
2. Asambleja e Përgjithshme ose Komiteti Drejtues në fund të vitit vendos për prioritetet e FSHSU-së (aktivitetet dhe koston e tyre) për vitin pasardhës, pra për Fondin Grand që do të kërkohet në MASR
3. Pasi MASR miraton Fondin Grand, detajimi i këtij fondi përcaktohet nga Komiteti Drejtues në bashkëpunim me Sekretarin e Përgjithshëm dhe Punonjësën e Financës.
4. Projektet Financiare të miratuara nga organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare.
  - a) Çdo vit organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare mund të mbështesin FSHSU-në me fond ose projekte për prioritetet të caktuar.
  - b) Me vlerën e fondit apo projektit anëtarësia e FSHSU-së duhet të informohet nga Komiteti Drejtues në momentin e aprovimit.
  - c) Financimi, kur është e mundur, duhet të kalojë në numrin e llogarisë dytësore të FSHSU-së.
5. Donacione nga sponsorë të ndryshëm.
  - a) FSHSU mund të përfitojë financime nga donatorë të ndryshëm nëpërmjet projekteve të veçanta.
  - b) Financimi duhet të kalojë në numrin e llogarisë dytësore të FSHSU-së.
  - c) Me vlerën e donacionit apo sponsorizimit anëtarësia e FSHSU-së duhet të informohet nga Komiteti Drejtues në momentin e aprovimit.
6. Sekretari i Përgjithshëm përcakton Komisionin e Blerjeve.
  - a) Komisioni i Blerjeve përbëhet nga Kryetari i Komisionit të Blerjeve dhe dy anëtarë (Sekretari i Përgjithshëm mund të jetë pjesë e këtij komisionit por jo kryetar).
  - b) Komisioni i Blerjeve duhet që për çdo blerje të sigurojë tre oferta dhe të zgjedhë ofertën më të mirë. Për këtë procedurë mbahet procesverbal. Çdo faturë me apo pa TVSH duhet të ketë firmën e të paktën një anëtar të komisionit.
7. Çdo blerje kryhet nga Komisioni i Blerjeve.
  - a) Blerjet kryen në përputhje dhe zbatim të vendimeve të Komitetit Drejtues të FSHSU-së;
  - b) Autorizimi për çdo blerje nënshkruhet nga Presidenti dhe Sekretari i Përgjithshëm, dhe i dërgohet për zbatim Nënpunësit Zbatues.

8. Të ardhurat nga Liçensimi Vjetor;
- Të gjitha Liçensimet Vjetore duhet të kalojnë në numrin e llogarisë dytesorë të FSHSU-së.
  - FSHSU është kliente e Credins Bank me Numër Llogarie 00001032308 IBAN AL26 2121 1016 0000 0000 0103 2308. Përdorues i kësaj llogarie është Presidenti i FSHSU.
  - Komiteti Drejtues i FSHSU-së vendos si do të shpenzohen të ardhurat e logarisë dytësore të FSHSU-së.
9. Fondi që mbledhet nga Liçensimet mund të përdoret për;
- financimin e kontratave të punësimit;
  - për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme sportive;
  - për pjesëmarrjen në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare;
  - për pajisjen me bazë materiale;
  - dieta, shpenzime udhëtimi, akomodimi;
  - pritje dhe përcjellje delegacioni;
  - shpenzime të kryera në dorë (të shoqëruara me fatura me TVSH);
  - botime (rregullore, librezë, etj);
  - mbarëvajtjen e faqes zyrtare të internetit;
  - konferenca dhe mbledhje;
  - kërkimit shkencor, etj.
10. Për të gjitha shpenzimet financiare të kryera nga Fondi Grand i MASR Përgjegjësi i Financës raporton në Asamblenë e fundvitit.
11. Për të gjitha shpenzimet financiare të kryera nga burimet e tjera financiare, Presidenti raporton në Asamblenë e fundvitit.

## NENI 15

### *Trajtimi financiar i punonjësve që dërgohen me shërbim brenda dhe jashtë vendit*

1. Trajtimi financiar i punonjësve për përballimin e shpenzimeve të shërbimit brenda vendit bëhet i diferencuar, sipas distancës së shërbimit nga qendra e punës:
- Për shërbime në një largësi deri në 50 km jashtë qendrës së punës, trajtimi financiar i punonjësit përfshin vetëm shpenzimet e transportit, në rastin kur transporti nuk realizohet nga vetë FSHSU;
  - Për shërbime në një largësi mbi 50 km jashtë qendrës së punës, kur punonjësi kthehet brenda ditës, trajtimi financiar i tij përfshin dietën ditore në masën 1000 (një mijë) lekë në ditë, si dhe shpenzimet e transportit, në rastin kur transporti nuk realizohet nga vetë FSHSU;
  - Për shërbime në një largësi mbi 100 km, jashtë qendrës së punës, trajtimi financiar i punonjësit përfshin:
    - Dietën ditore në masën 1000 (një mijë) lekë në ditë, kur punonjësi kthehet brenda ditës;
    - Kur shërbimi zgjat më shumë se një ditë, dieta ditore në shumën 2500 (dy mijë e pesëqind) lekë në ditë. Për efekt të llogaritjes së dietës, data e nisjes dhe ajo e kthimit llogariten një ditë e plotë.



- d) Shpenzimet e fjetjes, kundrejt dokumentit tatimor përkatës, të paraqitur nga hoteli dhe të shoqëruar me faturën e printuar nga kasa elektronike fiskale, por jo më shumë se 6000 (gjashtë mijë) lekë për çdo natë;
  - e) Shpenzimet e transportit, kundrejt dokumentit tatimor përkatës, në rastin kur transporti nuk realizohet nga vetë FSHSU,
2. Trajtimi financiar i punonjësve që dërgohen me shërbim në vendet e kontinentit evropian bëhet në Euro, ndërsa për vendet e kontinenteve të tjera në USD (dollar amerikan).
- a) Trajtimi financiar i punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit përfshin:
    - i. Dietën ditore;
    - ii. Shpenzimet e transportit;
    - iii. Shpenzimet e fjetjes;
    - iv. Shpenzimet për pagesa të ndryshme;
  - b) Trajtimi financiar i punonjësve miratohet me urdhër shërbim nga Sekretari i Përgjithshëm i FSHSU dhe Presidenti i FSHSU dhe më pas i kalon Nënpunësit Zbatues të FSHSU.
  - c) Për efekt të llogaritjes së dietave, dita e nisjes dhe e kthimit nga shërbimi, konsiderohet një ditë e plotë.
  - d) Masa e dietës përllogaritet në masën 35 Euro/USD në ditë.
  - e) Në shpenzimet e transportit, përfshihen:
    - i. Shpenzimet e transportit vajtje-ardhje jashtë vendit;
    - ii. Shpenzimet e transportit nga aeroporti në destinacion dhe anasjelltas;
    - iii. Shpenzimet për lëvizjet në qytete të ndryshme, për nevoja pune, brenda shtetit përkatës, të cilat janë përcaktuar paraprakisht në urdhër shërbimin përkatës;
  - f) Nga shpenzimet e fjetjes, përfshihet fatura e hotelit të përzgjedhur si rregull, në mënyrë të diferencuar sipas funksionit:
 

i. Presidenti	Hotel me 4 deri 5 yje;
ii. Sekretari i Përgjithshëm	Hotel me 4 yje;
iii. Zëvendëspresidenti	Hotel me 4 yje;
iv. Anëtarët e KD	Hotel me 3 deri 4 yje;
v. Të tjerë	Hotel me 3 yje.
3. Trajtimi financiar i punonjësve, për mbulimin e shpenzimeve të përcaktuara në pikën 1 dhe 2 të këtij neni, përballohet nga fondet përkatëse të FSHSU.

## NENI 16

### *Komisioni Teknik*

1. Komisioni Teknik përbëhet nga jo më pak se 5 persona:
  - a) Kryetari ose Drejtori Teknik.
  - b) Katër Anëtarë.
2. Kompetencat e Komisioni Teknik janë:
  - a) Zbaton vendimet e Komitetit Drejtues.
  - b) Vendos për çdo çështje që ka të bëjë me problemet teknike.

- c) Vendos për dhënien e titullit "Sportisti Universitar më i mirë" apo "Trajneri universitar më i mirë" për aktivitetin.
- d) Vendos për ngritjen e Komisionit të Testimit.
- e) Propozon në Komitetin Drejtues emrat e sportistëve, trajnerëve apo gjyqtarëve të cilët mund të përfitojnë shpërblim.
- f) Propozon në Asamblenë emrat e kandidatëve për tituj nderi.
- g) Është përgjegjës për nivelin teknik të FSHSU-së në përgjithësi.
- h) Është përgjegjës për nivelin teknik të Komisionit të Gjyqtarëve
- i) Është përgjegjës për organizimin e aktiviteteve me karakter kombëtar ose mbarëkombëtar që organizon FSHSU.

3. Kandidati për postin e **Drejtorit Teknik** duhet:

- a) Jo domosdoshmërisht të jetë shtetas shqiptar;
- b) Të ketë arsim të lartë;
- c) Të ketë moshë mbi 18 vjeç dhe nën 45 vjeç;
- d) Të ketë figurë të pastër morale;
- e) Të mos ketë konflikt interesi me vendimet që merren nga Komisioni Teknik;
- f) Të ketë kontribuar në sportin universitar;
- g) Të mos jetë njëkohësisht anëtar i zgjedhur në forumet drejtuese në një federatë tjetër.
- h) Të jetë propozuar nga një anëtar i federatës.
- i) Mandati i tij është 4 vjeçar (me përjashtim të rasteve kur Komiteti Drejtues vendos ndryshe).

4. Kompetencat e Drejtorit Teknik janë:

- a. Zbaton vendimet e Komitetit Drejtues;
- b. Përcakton detyrat për anëtarët e Komisionit Teknik;
- c. Duhet të jetë prezent në jo më pak se 50 + 1%, në mbledhjet e Komitetit Drejtues;
- d. Merr pjesë në hartimin e programeve stërvitore;
- e. Duhet të jetë prezent në jo më pak se 50 + 1% të seancave stërvitore të ekipeve përfaqësuese në garat ndërkombëtare;
- f. Informon Komitetin Drejtues për ecurinë e programit stërvitor të ekipeve përfaqësuese në garat ndërkombëtare;
- g. Është pjesë e stafit të ekipeve përfaqësuese në aktivitetet ndërkombëtare (sipas mundësive financiare të federatës);
- h. Nuk ndërhyr në vendimet që merr trajneri i ekipit përfaqësues;
- i. Propozon dy emra për titullin "Sportisti Universitar më i mirë" apo "Trajneri Universitar më i mirë";
- j. Gjatë aktiviteteve që organizon FSHSU-së, për sjellje apo veprime në kundërshtim me Statutin dhe Rregulloren e Brendshme ka të drejtë të jape Masën Disiplinore "Pezullim" e cila ka veprim të menjëhershëm për gjyqtarë, trajnerë, sportistë apo anëtarë të stafit organizator.

5. Anëtari i Komisionit Teknik duhet:

- a) Të jetë anëtar i FSHSU-së;
- b) Të ketë arsim të lartë;
- c) Të ketë moshë madhore;
- d) Të mos ketë masë disiplinore nga federata;
- e) Të ketë figurë të pastër morale;



- f) Të ketë fituar tituj gjatë karrierës së tij si sportist apo trajner dhe/ose gjatë karrierës akademike;
- g) Të mos jetë njëkohësisht anëtar i zgjedhur në forumet drejtuese në një federatë tjetër;
- h) Të jetë propozuar nga një anëtar i federatës;
- i) Mandati i tij është 4 vjeçar (me përjashtim të rasteve kur Komiteti Drejtues vendos ndryshe);
- j) Propozon dy emra për titullin "Sportisti Universitar më i mirë" apo "Trajneri Universitar më i mirë".

6. Veprimtaria:

- a) Komisioni Teknik fillon mbledhjet vetëm kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij;
- b) Komisioni Teknik merr vendime me 50 + 1% të anëtarëve të pranishëm. Në rastin e votave të barabarta Drejtori Teknik ka votë vendimtare kur votimi është i hapur.
- c) Në rast se një anëtar i Komisionit Teknik ka konflikt interesash me çështjen për të cilën debatohet apo votohet ai përjashtohet nga debati dhe votimi për këtë çështje;
- d) Vendimet a marra regjistrohen në procesverbal;
- e) Vendimet e marra hynë në fuqi menjëherë përveç rasteve kur Komisioni Teknik vendos ndryshe.

**NENI 17**

*Komisioni i Gjyqtarëve*

1. Komisioni i Gjyqtarëve përbëhet:
  - a) Kryegjyqtari;
  - b) 5 ose më shumë gjyqtarë.
2. Kompetencat e Komisionit të Gjyqtarëve janë:
  - a) Zbaton vendimet e Komitetit Drejtues.
  - b) Propozon, për dhënien e masave disiplinore.
  - c) Propozon për shkarkim Gjyqtarët nga Komisioni i Gjyqtarëve.
3. Kandidati për postin e Kryegjyqtarit duhet:
  - a) Të ketë arsim të lartë;
  - b) Të ketë Liçensë si Gjyqtar Ndërkombëtar ose Kombëtar;
  - c) Të ketë minimalisht një kualifikim sportiv;
  - d) Jo domosdoshmërisht të jetë shtetas shqiptar;
  - e) Të mos ketë masë disiplinore nga federata;
  - f) Të ketë figurë të pastër morale;
  - g) Të mos jetë njëkohësisht anëtar në federatë tjetër;
  - h) Mandati i tij është 4 vjeçar me të drejtë rikandidimi.
4. Kompetencat e Kryegjyqtarit janë:
  - a) Është përgjegjës për hedhjen dhe publikimin e shortit apo deklaratimet e sportistëve në aktivitetet që zhvillon FSHSU;
  - b) Përzgjedh stafin e gjyqimit në aktivitet kombëtare;
  - c) Përzgjedh gjyqtarët që mund të arbitrojnë në aktivitet ndërkombëtare.

5. Gjyqtari i FSHSU-së duhet:
  - a) Të ketë arsim të lartë.
  - b) Të ketë Liçensë si Gjyqtar Ndërkombëtar ose Kombëtar.
  - c) Jo domosdoshmërisht të jetë shtetas shqiptar.
  - d) Të mos ketë masë disiplinore nga federata.
  - e) Të ketë figurë të pastër morale.
6. Pagesa e Anëtarëve të Komisionit të Gjykatëve në varësi të financave të FSHSU-së, varion nga 2000 (dy mijë) – 5000 (pesë mijë) lekë.
7. Pagesa miratohet nga Komiteti Drejtues në vendimin e detajimit të Fondit Grand. Komiteti Drejtues ka kompetencë të ndryshojë këtë vlerë, kur aktiviteti nuk financohet nga Fondi Grand i MASR.

## NENI 18

### *Komisioni i Disiplinës*

1. Komisioni i Disiplinës përbëhet nga jo më pak se 3 persona:
  - a) Kryetari
  - b) Dy ose më shumë Anëtarë.
2. Kompetencat e Komisioni të Disiplinës janë:
  - a) Zbaton vendimet e Komitetit Drejtues.
  - b) Shqyrton ankimimet e anëtarësisë.
  - c) Vendos për dhënien e Masave Disiplinore (masa disiplinore e dhënë prej tij është objekt ankimimi vetëm në KAS).
  - d) Për çështje që i gjykon të arsyeshme, me një Vendim të veçantë ia kalon këtë kompetencë Komitetit Drejtues ose Asamblesë.
3. Kryetari i Komisionit të Disiplinës duhet:
  - a) Të ketë arsim të lartë;
  - b) Të ketë moshë madhore;
  - c) Të jetë shtetas shqiptar;
  - d) Të mos ketë masë disiplinore nga federata;
  - e) Të ketë figurë të pastër morale;
  - f) Të mos ketë konflikt interesi me vendimet që merren nga Komisionit i Disiplinës.
4. Anëtari i Komisionit të Disiplinës duhet:
  - a) Të ketë arsim të lartë;
  - b) Të ketë moshë madhore;
  - c) Të jetë shtetas shqiptar;
  - d) Të mos ketë masë disiplinore nga federata;
  - e) Të ketë figurë të pastër morale;
  - f) Të mos ketë konflikt interesi me vendimet që merren nga Komisioni i Disiplinës.
5. Veprimtaria:
  - a) Monitoron dhe siguron zbatimin e Kodit të Etikës të FSHSU;



- b) Diskuton probleme të etikës së jetës universitare;
- c) Vëzhgon zbatimin e dispozitave të këtij kësaj rregulloreje dhe propozon ndryshime, përmirësime apo masa të tjera detyruese, që kanë të bëjnë me etikën në FSHSU;
- d) Jep masat disiplinore të parashikuara në Statutin, Rregulloren dhe Kodin e Etikës të FSHSU;
- e) Propozon procedimin disiplinor të parashikuar organit që ka kompetencën si dhe të japë masa ndëshkimore sipas Statutit, Rregullores dhe Kodit të Etikës së FSHSU.
- f) Komisioni i Disiplinës fillon mbledhjet vetëm kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij;
- g) Komisioni i Disiplinës merr vendime me 50 + 1% të anëtarëve të pranishëm. Në rastin e votave të barabarta Kryetari ka votë vendimtare kur votimi është i hapur;
- h) Në rast se një anëtar i Komisionit të Disiplinës ka konflikt interesash me çështjen për të cilën debatohet apo votohet ai përjashtohet nga debati dhe votimi për këtë çështje;
- i) Vendimet a marra regjistrohen në procesverbal;
- j) Vendimet e marra hynë në fuqi menjëherë përveç rasteve kur Komisioni i Disiplinës vendos ndryshe.

## NENI 19

### *Komisioni i Financës*

1. Komisioni i Financës përbëhet nga jo më pak se 3 persona:
  - a) Kryetari;
  - b) Dy ose më shumë Anëtarë.
2. Kryetari dhe Anëtarët e Komisionit të Financës duhet:
  - a) Jo domosdoshmërisht të jenë anëtar të FSHSU-së;
  - b) Të kenë arsimin e lartë;
  - c) Të ketë moshë madhore;
  - d) Të jenë shtetas shqiptar;
  - e) Të mos kenë masë disiplinore nga federata;
  - f) Të kenë figurë të pastër morale.
3. Kompetencat e Komisioni të Financës janë:
  - a) Zbaton vendimet e Komitetit Drejtues.
  - b) Harton projektet për dhënie shpërblimesh.
  - c) Kërkon dhe mban dokumentacion, për aktivitetin e sponsorëve dhe donatorëve të ndryshëm.

## NENI 20

### *Komisioni i Apelit*

1. Komisioni i Apelit përbëhet nga jo më pak se 3 persona:
  - c) Kryetari
  - d) Dy ose më shumë Anëtarë.

2. Kompetencat e Komisioni të Apelit janë:
  - e) Zbaton vendimet e Komitetit Drejtues.
  - f) Shqyrton ankimimet dhe apelimet e anëtarësisë.
  - g) Për çështje që i gjykon të arsyeshme, me një Vendim të veçantë ia kalon këtë kompetencë Komitetit Drejtues ose Asamblesë.
3. Kryetari i Komisionit të Apelit duhet:
  - g) Të ketë arsim të lartë;
  - h) Të ketë moshë madhore;
  - i) Të jetë shtetas shqiptar;
  - j) Të mos ketë masë disiplinore nga federata;
  - k) Të ketë figurë të pastër morale;
  - l) Të mos ketë konflikt interesi me vendimet që merren nga Komisioni i Apelit.
4. Anëtar i Komisionit të Apelit duhet:
  - g) Të ketë arsim të lartë;
  - h) Të ketë moshë madhore;
  - i) Të jetë shtetas shqiptar;
  - j) Të mos ketë masë disiplinore nga federata;
  - k) Të ketë figurë të pastër morale;
  - l) Të mos ketë konflikt interesi me vendimet që merren nga Komisionit të Apelit.
5. Veprimtaria:
  - k) Komisioni i Apelit fillon mbledhjet vetëm kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij;
  - l) Vëzhgon zbatimin e dispozitave të këtij kësaj rregulloreje dhe propozon ndryshime, përmirësime që kanë të bëjnë me veprimtarinë në FSHSU;
  - m) Komisioni i Apelit merr vendime me 50 + 1% të anëtarëve të pranishëm. Në rastin e votave të barabarta Kryetari ka votë vendimtare kur votimi është i hapur;
  - n) Në rast se një anëtar i Komisionit të Apelit ka konflikt interesash me çështjen për të cilën debatohet apo votohet ai përjashtohet nga debati dhe votimi për këtë çështje;
  - o) Vendimet a marra regjistrohen në procesverbal;
  - p) Vendimet e marra hynë në fuqi menjëherë përveç rasteve kur Komisioni i Disiplinës vendos ndryshe.

## NENI 21

### *Ekipet përfaqësuese*

1. Ekipi i shoqatës sportive studentore që ka fituar titullin "Kampion Kombëtar Universitar", për një disiplinë sportive të caktuar, fiton të drejtën për të përfaqësuar vendin, në atë disiplinë, në garat ndërkombëtare.
2. Sportisti universitar që ka fituar titullin "Kampion Kombëtar Universitar", automatikisht fiton të drejtën për të qenë pjesëtar i ekipit përfaqësues.



3. Ekipet përfaqësuese në garat kombëtare dhe ndërkombëtare mbliohen me vendim të Komisionit Teknik në çdo periudhë të vitit.
4. Veprimtaria e ekipeve përfaqësuese përcaktohet me një Vendim të veçantë të Komitetit Drejtues që ndryshe quhet dhe Protokollit i Ekipit Përfaqësues dhe duhet të përmbajë:
  - a) Hierarkinë dhe funksionin e personave pjesëmarrës;
  - b) Intenerari dhe kohën e lëvizjes;
  - c) Adresën e mbërritjes, akomodimin, akreditimin, kthimin, etj.
5. Rendi i përcaktimit të Kryetarit të Delegacionit të ekipeve është si më poshtë:
  - a) Presidenti;
  - b) Sekretari i Përgjithshëm;
  - c) Zëvendëspresidenti;
  - d) Një nga anëtarët e Komitetit Drejtues;
  - e) Drejtori Teknik;
  - f) Trajneri i ekipit përfaqësues.
6. Kompetencat e Shefit të Delegacionit.
  - a. Përfaqëson FSHSU-në dhe ushtron të drejtën votës në aktivitetin ku merr pjesë;
  - b. Mban në informim të vazhdueshëm organet drejtuese të FSHSU-së dhe anëtarët e ekipit përfaqësues gjatë gjithë kohës;
  - c. Është përgjegjës për veprimtarinë e anëtarëve të ekipit përfaqësues (mënyrën e veshjes, kodin etik të sjelljes në ambjentet sportive dhe jashtë tyre, etj);
  - d. Është përgjegjës për dokumentacionin e ekipit përfaqësues (biletat e udhëtimit, deklaratat noteriale, faturat e akomodimit, taksën e pjesëmarrjes, etj);
  - e. Pas aktivitetit jep relacion të detajuar tek Sekretari i Përgjithshëm dhe Komiteti Drejtues;
  - f. Kryetari i Delegacionit është përgjegjës për respektimin me rigorozitet të Protokollit të Ekipit Përfaqësues;
  - g. Për çdo të papritur që mund të ndodhë gjatë udhëtimit është i detyruar të informojë strukturat drejtuese të FSHSU-së duke pritur udhëzime.
  - h. Për çdo procedurë jashtë protokollit duhet të mbajë porcesverbal së bashku me trajnerët e ekipit përfaqësues.
  - i. Ndalohej kategorikisht udhëtimi me ekipin kombëtar i personave jashtë listës së miratuar nga Komitetit Drejtues, apo transportimi i materialeve jashtë inventarit personal të anëtarëve të ekipit përfaqësues.
7. Komiteti Drejtues vendos për përbërjen e ekipit përfaqësues (trajnerin dhe sportistët) në rastet e mëposhtme:
  - a) Ekipi përfaqësues financohet nga fondi i federatave ndërkombëtare, (kur financimi nuk mjafton për të gjithë anëtarët);
  - b) Ekipi përfaqësues financohet nga fondi i MASR, (kur financimi nuk mjafton për të gjithë anëtarët);
  - c) Ekipi përfaqësues financohet nga donatorë privatë të kontaktuar nga FSHSU-së, (kur financimi nuk mjafton për të gjithë anëtarët);
  - d) Kur pjesëmarrja në ekipin përfaqësues financohet nga donatorë privatë të kontaktuar nga vetë shoqatat e FSHSU-së, duhet të respektohen kushtet e mëposhtme:

- a) Shoqata që ka siguruar financimin të sigurojë pjesëmarrjen e të paktën një personi tjetër të FSHSU-së (drejtues ose sportist) në ekipin kombëtar;
  - b) Kur pjesëmarrja në ekipin kombëtar financohet nga vetë individët që do të marrin pjesë në këtë aktivitet.
8. Nuk mund të marrë pjesë në ekipin kombëtar një sportist universitar që nuk ka marrë pjesë në Kampionatin Kombëtar.
9. Në rast se sportisti kampion nuk është prezent në grumbullimin e ekipit përfaqësues, ose nuk dëshiron të jetë pjesë e tij, këtë vend e zë zëvendëskampioni i po asaj kategorie.
10. Sportistët që janë shpallur Kampion Kombëtar Universitar, por që nuk stërviten në territorin e Republikës së Shqipërisë, mund të jenë pjesë e ekipit përfaqësues.
11. Pjesëtarët e ekipit kombëtar gjatë periudhës që janë brenda ose jashtë vendit duhet:
- a) Të njohin si autoritetin më të lartë Kryetarin e Delegacionit.
  - b) Të respektojnë statutin dhe rregulloret e FSHSU-së
  - c) Të respektojnë të gjitha marrëveshjet apo kontratat midis FSHSU-së dhe palëve të interesuara.
  - d) Të respektojnë simbolet kombëtare dhe të manifestojnë një sjellje korrekte në çdo situatë.
- a) Uniforma zyrtare e ekipit përfaqësues përcaktohet me vendim të Komitetit Drejtues, ajo duhet të përmbajë:
- a. Simbolet kombëtare
  - b. Simbolet e FSHSU-së
  - c. Simbolet e IAL-së
  - d. Logon e sponsorit të përgjithshëm në rast se ka
  - e. Logon e sponsorëve të tjerë në rast se gjykohet e dobishme
  - f. Uniforma zyrtare është e detyrueshme për të gjithë anëtarët e ekipit përfaqësues i cili paraqitet me këtë uniformë në:
    - i. Seancat stërvitore
    - ii. Para, gjatë dhe pas aktivitetit
    - iii. Në publik dhe intervista të ndryshme televizive, etj.

## NENI 22

### *Dispozita të fundit*

1. Anëtarët e FSHSU-së që shkelin parimet dhe dispozitat e kësaj Rregulloreje, kur nuk përbën vepër penale, do të ndëshkohen me masa disiplinore sipas rastit, të parashikuara në Statutin dhe në Rregulloren e Brendshme.
2. Rregullorja e Brendshme u hartua në Mars 2018 me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.



**BESNIK VELIU, PRESIDENT**



**MIMOZA TARE**



**ULPIAN HOTI**

**TAULAND SPAHË**



**GJERGJ ILIADHI**



**ERVIN PEPI, SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

